

VENDIM
Nr.173, datë 19.2.2009

**PËR MIRATIMIN E FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIOS DHE TELEVISIONIT, PËR VITIN 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin, publik e privat, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2009, në shumën 75 500 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, zëri “Shpenzime korrente”, dhe 55 000 0000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, zëri “Investime” .
2. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha